



# Lajmëtari i Radio Marisë

Janar 2012

Viti IV, Nr. 1

## Në këtë numër do të lexoni

- Takimi i vullnetarëve të Radio Marisë në Lezhë 2
- Vullnetarët e Radio Marisë janë shërbëtorë si Maria 3
- Shpallim Ungjillin 4

Lajmëtari i Radio Marisë është organ i Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4  
Fushë Kërçik, Babrru, Paskuqan  
Tiranë, Shqipëri  
+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II  
Shkodër, Shqipëri  
+355 22 24 08 52

Lezhë

Sheshi Besëlidhja  
Lezhë, Shqipëri  
+355 215 24 970

E-mail: [info@alb.radiomaria.org](mailto:info@alb.radiomaria.org)

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

Radio Maria,  
Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,  
mund të dëgjohet në:

Prëshen e rrethina  
FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat  
FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin  
FM 102.2 MHz  
Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras  
FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,  
Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

[www.radiomaria.al](http://www.radiomaria.al)

## PËR SHUMË MOT KËRSHËNDELLAT!

Të dashur miq,  
Këtyre ditëve kemi kremtuar Kërshëndellat, që është biseda e Hyjit që njeriu e kupton më së miri; vizitën personale që Hyji ia bëri secilit prej nesh, botës dhe tokës. Kremtuam vizitën e dashurisë që Hyji ia fali botës, në të cilën nuk ka dashuri. Festuam të kremten e takimit personal të Hyjit me njeriun, atë takim personal të secilit njeri me zotërinë e vet, të kremten e ftohtësisë së zemrës sonë dhe të ngrohtësisë së zemrës së Hyjit, të errësirës sonë dhe të dritës së Hyjit. Ai erdhi te çdo njeri dhe tha 'ma hap zemrën, dua të takohem me ty, dua t'i heq tashmë të gjitha prangat e robërisë, dua t'i zhdruk frikësimet, duke e vendosur praninë dhe dashurinë time në ty'. Patëm mundësi që afër grazhdit ta sodisim Zotin tonë dhe ta lejojmë që të na përqafojë dhe të na ngrohë me praninë dhe dashurinë e tij.

Gjatë vitit 2011, zëri i Radio Marisë në Shqipëri dhe në botë, falë secilit prej jush, jehoi më fuqishëm. Jehoi dhe e shpalli porosinë e Jezu Krishtit, Birit të Hyjit, Shëlbuesit tonë, Emanuelit, Zotit me ne, duke bërë që paqja dhe gëzimi i vërtetë të vijë në shumë njerëz dhe në shumë familje në të katër anët e botës, duke bërë që njerëzit të jetojnë përmasat e kërkesave themelore të shpirtit të tyre: të jetojnë në paqe dhe të jenë të gëzuar. Zoti hyri në shumë zemra që nuk kishin paqe dhe qetësi. E vendosi në to paqen që vetëm Ai mund ta dhurojë. Kur askush dhe asgjë tjetër nuk mundi t'i qetësojë dhe t'i përmbushë njerëzit, erdhi Zoti dhe hiri i tij përmes valëve të Radio Marisë dhe njerëzit e përjetuan Atë të gjallë në mesin e tyre. Në fundin e vitit 2011, me rastin e festës së Kërshëndellave, e falënderuam Zotin që na viziton, e falënderuam për të gjithë lajmëtarët e paqes dhe të gëzimit që e shpallën praninë e Tij në Radio Mari.

Breznitë e ndryshme në popullin tonë dhe në mbarë njerëzimin janë fatlume, sepse kanë përjetuar ato gjëra që të tjerat nuk i kanë përjetuar. Ne mund ta shikojmë brezninë tonë që ka mundësi të gëzohet për shkak të vizitës që Zoti ia bën secilit njeri dhe secilës familje, sepse Zoti u kthye përsëri ndër ne. Gëzohemi për shkak të ngushëllimit që dëgjuesit e Radio Marisë e përjetojnë secilën ditë. Gëzohemi për shkak të

shëlbimit që po vjen në zemrat e vëllezërve dhe të motrave tona në vendin tonë dhe në mbarë botën.

Mirëpo, më duhet të them me përgjegjësi se gjithmonë ka njerëz, familje e brezni që nuk dinë ta njohin vizitën e hirit të Hyjit. Gjithmonë ka njerëz që e përbuzin hirin. Kështu ndodhi në Betlehem në Kërshëndellat e para. Kështu mund të ndodhë edhe sot, në zemrën time, në mesin tonë, në familjet dhe në popullin tonë. Për këtë gjë na flet edhe Jezusi dhe na bën vërejtje, së bashku me banorët e Jerusalemit, që nuk e njohën vizitën e Hyjit. Por, gjithashtu mund të themi me mburrje, që lind në hirin e Hyjit, se sot shumë njerëz i gëzohen vizitës së Zotit për shkak të punës së bërë nga Radio Mari gjatë këtyre tetë viteve e gjysmë të jetës së saj në popullin tonë. Të gjithë së bashku kemi arsye t'i gëzohemi vizitës së Zotit dhe e falënderojmë së bashku për ngushëllimin që na e dhuron me praninë e vet. E falënderojmë që i përmbushi familjet tona, bashkësitë tona, popullin tonë me praninë, paqen dhe gëzimin e Tij. E falënderojmë që na e jep hirin për t'u lutur që populli ynë çdo ditë e më shumë të ketë mundësi t'i njohë çastet e vizitës dhe të pranisë së Tij në mesin tonë.

E falënderojmë Zotin që, përmes mësimëve që shpallen në Radio Mari, po e hap rrugën e shëlbimit për çdo njeri. Të gjithë jemi të ftuar që të bashkohemi me Zotin: dashtë Zoti që t'u përngajmë barinjve, që pasi ta dëgjojmë Lajmin e qiellit, të gjithë të shkojmë në Betlehem. Shëlbimi po iu dëftohet të gjithëve. Të gjitha skajet e botës duhet ta shohin Hyjin Shëlbues. Kjo është detyra e vazhdueshme e njerëzve që shpallin Lajmin e gëzueshëm, kjo është detyra e të gjithë dëgjuesve, vullnetarëve e bashkëpunëtorëve të Radio Marisë. Lajmin e gëzueshëm duhet ta sjellim së bashku deri në skajet e tokës. Jemi të lumtur që e njohëm Zotin e t'u themi të gjithëve: Ai është i vetmi Shëlbues! I frojmë të gjithë njerëzit që të vijnë te Ai dhe ta marrin shëlbimin e tij. Jezusi që lindi në Betlehem, për ne, na dhuroftë hirin që gjatë vitit 2012 të jemi dëshmitarët e pranisë së tij në jetën e secilit prej nesh. Ky le të jetë urimi i Kërshëndellave dhe kërkesa që ia bëj Zotit për secilin që e lidh jetën me Radio Marinë për këtë vit të ri që po e nisim.

Don Preka



## TAKIMI I VULLNETARËVE TË RADIO MARISË NË LEZHË



**Shënim i redaksisë:** Në datën 17 dhjetor 2011, në Lezhë, Radio Maria Shqiptare kremtoi Meshën e Shenjtë dhe zhvilloi një takim me vullnetarët dhe bashkëpunëtorët e saj në mbarë vendin. Në këtë numër dhe në atë në vijim, ju do të mund të lexoni fjalën e Presidentes së Radio Marisë dhe mësimet e Atë Fvivo Kavalini, Don Lorenzo Roseti dhe të përfaqësuesit të RM Botërore, Zotëri Bernardo Miteruncenr që ishin pjesë e këtij takimi.

Të dashur bashkëpunëtorë dhe miq të Radio Marisë, me gëzim të madh dëshiroj t'ju uroj mirëseardhjen në këtë çast shumë të rëndësishëm për RM-së Shqiptare. E falënderoj Atë Flavion për kremtimin e Meshës së Shenjtë për ne këtu në emër të Zotit. E falënderoj edhe përfaqësuesin e Familjes Botërore të RM-së, z. Bernhard Mitteruntzner për praninë e tij dhe Don Lorenzo Resseti për mësimin. Ju falënderoj për zemërsisht juve, vullnetarë kryesorë të RM-së në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e Zvicër, që keni punuar me përkushtim, gatishmëri e seriozitet në përbushjen e detyrës që ju

është besuar si ndërmjetës të RM-së dhe vullnetarëve të terrenit. Ju jeni menaxherët e vullnetarëve individualë në bashkërendimin e veprimeve, shpërndarjen e materialeve dhe organizimin e takimeve.

Kërkohet nga të gjithë ju që të njihet mirë projekti i RM-së dhe të kuptohet misioni i saj i veçantë, që është sjellja e Jezusit Shpëtimtar në botë. Çdo njeri do të donte që ta dëgjonte mesazhin e vërtetë fetar e të jetë i aftë të rritet shpirtërisht. RM është një mjet që i përgjigjet thirrjes së Virgjërës Mari përmes lutjeve dhe mësimin të fesë katolike, sepse:

- e sjell Ungjillin në popull.
- dhuron qetësi dhe shpresë tek ata që janë të varfër, të vetmuar dhe në vuajtje, duke përhapur lajmin se e Jezusi ekziston në Kishën e tij dhe në të bëhen lutje, shpallet Lajmi i Gëzueshëm, mësohet dhe shërohen shpirtat. Në këtë mënyrë, Radio Maria i ndihmon të krishterët për ta konkretizuar atë që propozon Kisha, pra lutjen.

Është e nevojshme që ju të dashur vullnetarë kryesorë t'i kushtoni 2-4 orë në javë veprimtarive të RM-së. Secili prej nesh duhet të angazhohet në detyrë me një seriozitet absolut, sepse lutja dhe liturgjia, të transmetuara me anë të radios, i përgjigjen nevojës shpirtërore të atyre që nuk e kanë mundësinë të shkojnë në kishë: të sëmurët, të vjetrit, të burgosurit, etj.

RM ka si shenjë themelore përshtetësinë ndaj Zojës së Bekuar: në thjeshtësi, në dorëzim dhe në dhurimin e plotë që paraqitet shkëlqyeshëm përmes punës vullnetare. Është detyra juaj që t'ua thoni me të madhe vullnetarëve të terrenit se i presim që të bashkohen me ne, në mënyrë që secili ta japë pjesën e vet. Edhe një orë në javë ose disa orë në muaj janë një ndihmesë e madhe në punën tonë. Çdo çast që e dhuroni është tepër i vlefshëm, edhe pse për nga koha mund të duket i vogël. Të gjithë ata që dëshirojnë të bashkohen me ne janë të mirëseardhur. Shumë herë gjatë këtyre viteve kemi hasur në vështirësi të ndryshme, ndonjëherë deri në dëshpërim dhe shpejt e kemi kuptuar se, nëse ecim me Marinë, nuk do ta humbasim rrugën.

Tani vullnetarët e terrenit janë një "realitet" i gjallë, gjithmonë i pranishëm me thjeshtësi dhe përvujtëri, ndërmjet njerëzve që jetojnë Marinë dhe Radion e saj, në të cilën vepron shpirti misionar i ungjillëzimit dhe që e përhapin duke ia bërë të njohur një numri sa më të madh njerëzish. Roli thelbësor i vullnetarëve të terrenit është që të shpallë në njerëz se Radio Maria:

- ekziston dhe mund t'i ndihmojë të gjithë ata njerëz që dëshirojnë t'i përballojnë në mënyrë të krishterë problemet e jetës së përditshme.
- është një mbështetje e vlefshme për atë që e ka nisur rrugën e besimit; është një udhëheqje e sigurt në kërkimin e së vërtetës.
- është një mike e sinqertë dhe pa interes për atë që është vetëm, i braktisur, i dëshpëruar, i sëmurë ose në burg.

Prapëseprapë, ky mision, kjo vepër e bamirësisë së ngutshme për kohën tonë, është në gjysmën e udhëtimit të vet, përderisa nuk ia del të mbulojë krejt sipërfaqen e vendit tonë. Sot kemi nevojë që të gjithë t'i drejtojmë zemrat tona drejt Hyjit, që ta zbulojmë praninë e tij, duke marrë si model të dëgjimit dhe të përgjigjes Nënë e Jezusit, Zojën Mari. Atëherë, kjo na lejon që ta zbulojmë se brenda veprave të bamirësisë, që lindin përbrenda Radio Marisë, qëllimi kryesor është përhapja e saj, duke kërkuar që Fjala e Jetës të arrijë te të gjithë shqiptarët. Të gjithë dëgjuesit, fëmijë, të rinj, të rritur, punëtorë apo studentë, të shëndoshë apo të sëmurë, mund të bëjnë që Radio Marinë ta njohin miqtë dhe familjarët e tyre. Le ta gjejmë mënyrën që t'i ndihmojmë ata që ta dëgjojnë ndonjë program, dhe kjo do të jetë për ta një ndihmë e madhe. Le t'i shfrytëzojmë çastet e lutjes për t'i ftuar ata që të na bashkëngjiten, duke rizbuluar së bashku me ta vlerën e lutjes së përbashkët. Të mos e harrojmë se **Hiri i Hyjit kalon përmes angazhimit tonë.**

Më lejoni që në emrin tuaj të propozoj që, në këtë kohë të Krishtlindjes, të gjithë ne që jemi këtu të angazhohemi për t'ia bërë një dhuratë RM-së dhe miqve e familjarëve tanë duke u lutur me ta, apo duke e dëgjuar një emision të radios apo ndonjë predikim të meshtarit. Kështu edhe rritja e RM-së do të jetë më e madhe. E kjo do të jetë dhurata më e mirë që mund tu bëjmë familjarëve dhe miqve tanë për festat e fundvitit.

E falënderojmë Familjen Botërore të RM-së për ndihmën e vazhdueshme që i ka dhënë RM-së Shqiptare përmes ndihmesës teknike dhe përballimit të vështirësive të ndryshme në të cilat hasim. Por, tani ka ardhur koha që ne ta përballojmë vetë më me vendosmëri jetën e Radios më angazhimin tonë me të madh në të gjitha aspektet, me lutje, bashkëpunim, ndihmë financiare që duhet ta japim. Nëse ndokush mendon se Radio Maria u përket plotësisht dëgjuesve të saj, kjo duket natyrshëm se si secili program i saj do të rritet fuqishëm kur ndihma nga dëgjuesit është më e madhe.

Më lejoni që në emrin tuaj ta falënderoj drejtorin e radios, Don Prekën, për punën e palodhur dhe të kujdesshme si udhërrëfyesi i parë dhe kryesor që e ka promovuar RM-në në vendin tonë, duke bërë që ajo të rritet nga viti në vit.

Faleminderit dhe qoftë lëvduar Jezu Krishti!

## VULLNETARËT E RADIO MARISË JANË SHËRBËTORË SI MARIA

Duke përgatitur Meshën e Shenjtë për ju vullnetarë të Radio Marisë, kam medituar më tepër mbi një fjalë të veçantë që lidhet sidomos me shpirtin e përgjithshëm të kohës së Ardhjes. Kjo është përgjigjja e Zojës Mari drejtuar Gabrielit krye-engjëll për lindjen e Krishtit kur tha “Unë jam shërbëtorja e Zotit”. Çfarë lidhje ka kjo fjalë me fjalën ‘vullnetar’?

Nuk dëshiroj të bëj një meditim mbi kuptimin që ka marrë sot në jetën e përditshme të shoqërisë tonë fjala vullnetar. Dua që ta shqyrtoj atë nga një pikëpamje krejtësisht ungjillore e shpirtërore, pra nga pikëpamja e krishterë. A mund të jetë një i krishterë vullnetar? Unë besoj se jo. Çka nënkuptohet normalisht për vullnetar? Nënkuptohet njeriu që bën diçka me vullnetin e vet; njeriu që ka një lloj protagonizmi për faktin që vendos për diçka dhe e kryen atë; njeriu që punon në punë vullnetare, që është diçka më tepër sesa puna e përditshme, që ka mundësi ta bëjë ose që është në zgjedhjen e tij të lirë e që mundet edhe të mos e bëjë. Vullnetar është dikush që punon falas. A mund të jetë e vërtetë një fjalë e tillë për një angazhim që është krejtësisht baritor dhe në fushën e Ungjillëzimit? Unë besoj se jo. Është kështu sepse ne jemi



bashkëpunëtorë të Zotit dhe nuk e ushtrojmë vullnetin tonë personal, përveç faktit që i themi po një vullneti tjetër – vullnetit të Atit. Ne, si të krishterë, jemi njerëz që lutemi e veprojmë duke thënë ‘u bëftë vullneti yt’, pra vullneti i Atit. Vullneti ynë është i lidhur dhe në varësi të plotë me vullnetin e Atit. Zoja Mari na paraqet një shembull të shkëlqyeshëm në këtë drejtim. Ajo e paraqet veten jo si vullnetare, por si shërbëtorja e Zotit. E në të vërtetë ne jemi shërbëtorë. Ju jeni këtu, jo sepse keni vendosur që thjesht të bëni diçka për Zotin, por sepse e keni kuptuar se Zoti i ka bërë të gjitha për ju dhe ju keni dëshirë që t’i përgjigjeni duke e pranuar vullnetin e tij në jetën tuaj. Kështu, ju bëni diçka që është vetëm jehonë e veprës së madhe e të pazëvendësueshme që ka bërë Ati për ne përmes Jezu Krishtit, njësoj siç ka vepruar edhe shërbëtorja e tij, Zoja Mari. Besoj se ky është shpirti i vullnetarizmit tonë këtu në Radio Mari dhe në Kishë në përgjithësi.

Ne jemi vullnetarë, sepse e pranojmë vullnetin e Atit, sepse pranojmë të jemi plotësisht bashkëpunëtorë në këtë plan shëlbimi dhe ungjillëzimi për ta shpallur Lajmin e Mirë ndër njerëz. Por, a mund të jemi vullnetarë në kuptimin se kemi ose jo mundësi për ta bërë këtë gjë? Edhe në këtë kuptim nuk është e mundur, në qoftë se jemi vërtet të krishterë që e kemi kuptuar se çfarë është pagëzimi, i cili na ka shenjtëruar dhe me të cilin i jemi kushtuar Zotit. A mund të themi se sot po ia kushtoj pak kohë Zotit e kohën tjetër po ia kushtoj punëve të mia. Në qoftë se e gjithë jeta jonë nuk është e drejtuar atje ku është vullneti i Atit, ne mbetemi gjithmonë njerëz të mirë, njerëz që bëjmë mirë, por jo njerëz që bashkëndajmë më të mirën që ekziston, të mirën e pazëvendësueshme, që është Hiri i Zotit që vjen ndër ne dhe që na e ndryshon jetën.

Atëherë, fjala që na drejton për ta kuptuar mënyrën me të cilën i përgjigjemi vullnetit të Atit është fjala e Krishtit që e lexojmë në Besëlidhjen e Vjetër: “Dua je Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë jetën tënde, me gjithë forcën tënde”. Pra, *me krejt mendjen tonë*, me të gjitha ndjenjat tona, mendimet, planet drejtuar Atij, për të kuptuar se si mund të përgjigjem, për të pranuar çka Ai ka bërë për ne dhe për t’u përgjigjur në mënyrë pozitive. Në të gjithë jetën tënde, nuk ekziston as edhe një fragment i asaj që ti nuk mund t’ia kushtosh krejtësisht Zotit. Jo vetëm pak kohë me të cilën bëjmë diçka për të tjerët, por të gjithë kohën e jetës time ta drejtoj kah Ati, që është në vullnetin e dashurisë.

*E me të gjitha forcat.* Forcat, në kuptimin e plotë, janë forcat materiale, energjitë trupore, por edhe forca ekonomike, edhe xhepat tanë janë forcë. Megjithatë, të gjitha mjetet e një të krishterë janë të kushtuara jo si një dëshirë e dijes tonë, por si një angazhim që është krejtësisht i drejtuar kah Zoti për të realizuar një projekt dashurie që kërkon gjithë ekzistencën tonë, çdo copëz të jetës tonë, çdo situatë, çdo vend. Nuk ekziston një vend ku nuk mund të bëhet kjo gjë. Për këtë arsye, besoj se të bashkëpunosh me Radio Marinë në këtë drejtim është diçka e bukur për faktin që është një mjet konkret, një mjet teknik, që na lejon të shkojmë në çdo vend, në çdo situatë, edhe aty ku nuk e dimë, nëpërmjet atyre që na dëgjojnë në vende të ndryshme, në situata të ndryshme të jetës, në mosha të ndryshme. Nuk ekziston një vend ku nuk mund të shkojë kjo fjalë. Prandaj, *me gjithë forcën tënde* do të thotë që t’i vendosim të gjitha mundësitë tona teknike dhe ekonomike për ta kryer planin e Zotit. Kemi mundësi për të thënë dua, po ose jo, ose e bëj një herë tjetër, ose po e bëj në një mënyrë të kufizuar, por në qoftë se e kemi kuptuar se çfarë është jeta e krishterë, atëherë besoj se nuk është kështu.

Pastaj, kjo është një punë që bëhet falas. Le ta pyesim veten: sa kemi paguar ne për shëlbimin tonë, sa kemi paguar ne për ta zbuluar fenë e krishterë? Sa kemi paguar ne që kemi pranuar fenë, dhe kemi pasur një visar të trashëguar pa meritat tona? Atëherë e kuptojmë se nuk ekziston një punë e krishterë me këtë karakteristikë që është me pagesë. Kështu e kuptojmë se që t’ia kushtojmë jetën tonë dhe krejt energjitë tona planit të Zotit është një mënyrë me të cilën vetëm shpaguajmë për diçka më të madhe që Zoti na e ka ofruar nëpërmjet vëllezërve të ndryshëm, nëpërmjet Kishës, nëpërmjet prindërve tanë, nëpërmjet situatave të ndryshme në të cilat kemi lindur, jemi rritur dhe kemi pasur këtë fat tepër të mirë që e kemi njohur dhe pranuar fjalën e Ungjillit, e që kemi mësuar të gëzojmë për veprën e Zotit në jetën tonë. Për këtë arsye, ne nuk kemi mund të mos bëhemi edhe ne lajmëtarë, si Gabrieli Krye-engjëll, për veprën që Zoti ka dëshirë ta sjellë në çdo njeri, sidomos tek ata që janë më larg, që janë më të vegjël e më në vështirësi, që kanë më pak mundësi, nëpërmjet këtij instrumenti të jashtëzakonshëm që është Radio Maria. Është një meditim i thjeshtë, por besoj se është i lidhur shumë me kohën e Ardhjes. Jemi gjithmonë në pritje për diçka që vjen prej Zotit. Të mos mendojmë se ne e zëvendësojmë Zotin, me çfarëdolloj mënyre, apo se kemi mundësi të bëjmë diçka që nuk është e lidhur me vullnetin e Tij, ose të jemi të kënaqur duke provuar një farë lloj protagonizmi që nuk ka vend, sepse i vetmi protagonist në gjithçka është Ai. Gëzimi ynë është fakti se Ai edhe një herë e shpall vetveten si të pranishëm, si veprues dhe si Shëlbues. Zoti është shkaku i gëzimit tonë. Qoftë lëvdur Jezu Krishti!

## SHPALLIM UNGJILLIN

Të dashur vullnetarë të Radio Marisë, ju falënderoj që keni ardhur këtu dhe që jeni. Dua ta filloj fjalimin tim me disa pyetje. A jeni ju të kënaqur me Jezusin, me të gjitha gjerat që ai i ka bërë dhe thënë? A jeni të kënaqur edhe për problemet e sëmundjet që jua ka dhuruar? A jeni të kënaqur që ai është Ringjallur dhe na pret? Edhe pse duke na pritur, Ai nuk rri atje lart, pasi nuk është i durueshëm, por na vjen në takim këtu në tokë. A jeni të kënaqur për të gjitha këto? Sepse ky është themeli i gjithçkaje. Pa këtë gëzim, pa këtë falënderim e mirënjohje, pa këtë hir, nuk mund ta bindim askënd. Unë sot dëshiroj t'ju flas për Radio Marinë dhe misionin e saj. Dëshiroj t'ju flas edhe për vullnetarizmin që nuk është asgjë tjetër veçse një dhurim falas. Dhe ne nuk falim diçka as çfarëdo, por dashuri. Kjo është e vetmja gjuhë që e kuptojnë të gjithë, e vetmja frekuencë që arrin t'i shndërrojë të gjithë. Pra, çka është Radio Maria? Radio Maria nuk është asgjë tjetër përveçse një shenjë e dashurisë, më mirë mund të themi një instrument i historisë së dashurisë mes Hyjit dhe njeriut. Ne e kemi kuptuar se Zoti dëshiron që ta përdorë këtë instrument për t'iu thënë njerëzve të kësaj breznie se i do, i pret, i shëron dhe se i sjell të gjithë në shtëpinë e vet. Nëse Zoja e Bekuar thotë "bëni gjithçka ju thotë", atëherë detyra jonë e madhe është që të bëjmë edhe ne si Maria. Së pari, ta ngjizim në kraharor Jezusin. Më pas, ta lindim Jezusin për njerëzit e pastaj, t'iu themi njerëzve "bëni çfarë t'ju thotë Jezusi".

Po çfarë është Radio Maria? Ajo në vetvete nuk është asgjë. Ne jemi në mesin e një historie dashurie, ku protagonistë janë Jezusi, Hyji, dhe njerëzit, shpirtat. Ne, që bashkëpunojmë, jemi transmetuesit. Pra, RM, në mbarë botën vetëm e mbledh krejt bukurinë e Jezusit, që banon në Kishën e tij, dhe ua sjell shpirtave. Kjo është Radio Maria. Në qoftë se unë jam këtu e ju flas për RM-në, unë nuk jam RM. Por, nga ana tjetër, edhe unë jam RM, sepse edhe unë e dëgjoj atë, e kërkoj Jezusin. Jam i bindur që secili prej jush e ka bërë këtë përvojë. Me siguri që ju ka prekur ndonjë fjalë që ka ardhur prej radios, e keni ndjerë në shpirt këtë gëzim, këtë dashuri të bashkëpunëtorëve, drejtuesve, dëgjuesve, e ndoshta, sikur ka ndodhur edhe në radiot e tjera, ka ndryshuar edhe ndonjë jetë, ndonjë plagë është mbyllur e ndonjë shpirt është kthyer kah Zoti. Pra, besoj se e kuptojmë se në fund të fundit, ne nuk mund ta bëjmë krejt atë çka do të bëjë RM. Atëherë, si mund të ngushëllohem? Si mund të kthehem? Si mund të japim shpresë? Kur unë flas, nuk jam i sigurt nëse ti je shëruar, je ngushëlluar. Ky është hiri i Zotit. Vetëm ai ngushëllon, shëron, jep shpresë. Pra, të gjitha frytet, e gjithë dinamika e RM-së është hir që jepet falas dhe dashuri. Jua them këtë, sepse kjo është shumë e rëndësishme për vullnetarët. Ne nuk guxojmë të vëmë si qëllim frytet dhe suksesin, edhe assesi nuk guxojmë të dëshpërohemi për shkak të mos suksesit. Ne e bëjmë çdo gjë prej dashurisë. Detyra jonë më e madhe është t'i duam njerëzit. Është më e mirë një orë punë me dashuri sesa pesëdhjetë orë për lavdi të kotë. Prandaj, ne duhet ta kuptojmë se edhe RM mund të kthehet në një instrument shumë të dëmshëm e të rrezikshëm, sepse shumë shpejt përmes saj ne bëhemi të njohur e me sukses. Kështu, ne duhet të kthehem gjithmonë kah dashuria mes Zotit edhe njerëzve, sepse kjo është dinamika, forca e RM-së, jo puna jonë.

Dëshiroj të kthehem edhe një herë te qëndrimi i Zojës Mari. Ajo e ka ngjizur Jezusin, Fjalën e Zotit që u bë njeri. E çka ndodh në jetën e saj? Ajo nuk ka më qetësi derisa nuk shkon te dikush për ta ndarë këtë gëzim që e ka në vetvete. Te kush shkon? Te Elizabeta. Tridhjetë vjet më pas, një grup tjetër njerëzish që e ngjizin Jezusin, nuk munden më të heshtin. Pjetri e Gjoni përpara Sinedrit - ata e kanë ngjizur Fjalën e Zotit, i kanë parë të gjitha mrekullitë e Jezusit dhe e kanë kuptuar se ata janë trupi i Jezusit. Ata janë duart e Jezusit, këmbët e Jezusit. Edhe ata nuk kanë mundësi të heshtin dhe u kanë thënë të gjithë njerëzve se është e pamundur të heshtin për gjërat që i kanë parë dhe dëgjuar. Ky është urimi, por është edhe thirrja që dëshiroj t'ia bëj secilit prej jush, që edhe juve t'ju prekë bukuria dhe hiri i Jezusit, që ta keni këtë dëshirë, këtë mall për tu sjellë Jezusin njerëzve të kësaj kohe të vendit tuaj. E falënderoj Zotin që e kemi një mundësi shumë të thjeshtë, sepse nuk jemi ne që predikojmë, por Radio Maria. Njerëzve u themi vetëm 'dëgjo Radio Marinë'. E kështu mund t'i çelim dy dyer: zemrën e njeriut dhe derën e Parajsës, që është dera e Zembrës së Krishtit.

Dua të flas pak për përvojën që e bëjnë vullnetarët tanë apo që duhet ta bëjnë. Filloni t'iu flisni njerëzve të ndryshëm në familje, në vendin ku jetoni, ndoshta për një radio të bukur, që është katolike, që është fetare. Edhe këtu ndodh gjithçka. Sepse nëse ju digjeni për këtë radio, dhe nëse i bëni këto gjëra për dashuri, atëherë ju jeni si shpata. Disa ju shohin dhe fillojnë të mendojnë 'këta njerëz kanë diçka më shumë'. Unë nuk e kam këtë gjë. Më duket se kanë diçka që unë nuk e kam, më mungon. Të jeni të sigurt se ky njeri që thotë kështu është shumë afër për ta marrë një radio e për t'ia nisur dëgjimit. Por, mund të ndodhë edhe që të hasni dështime, që njerëzit të kërkojnë t'i lini të qetë, pasi nuk duan të dëgjojnë për Hyjin që është dashuri apo për të krishterët, Kishën, e për rrjedhojë t'ju quajnë të marrë e t'ju mbajnë për asgjë. Edhe ne kur i dëgjojmë këto fjalë, nëse i dëgjojmë në mënyrë njerëzore, kjo është shkatërrim, sepse ne nuk kemi sukses. Por, nëse i njohim mirë fjalët e Ungjillit, atëherë këto janë momentet në të cilat duhet të gëzoheni dhe duhet ta lëvdoni Hyjin, sepse ju si vullnetarë e keni bërë detyrën tuaj. Zoti ju ka nderuar që ta përjetoni një të keqe dhe ju e keni lëvdur Zotin. Pikërisht këtë gjë e kam menduar pak më parë. Kur ju kam parë duke ardhur, i kam thënë Zotit se si mund të kuptohet kjo shenjë e kohës. Nuk ka pasur një kohë më të bukur se kjo e sotmja. Për mua, shiu që ju ka përcjellë juve ka qenë një bisedë të cilën Zoti ka thënë 'unë dua t'ju prek me Hirin tim'. Një erë e tmerrshme që ju ka thënë 'dua t'ju dëgjoj në mbarë botën'. Dhe atëherë kam parë pak diell që tha 'ejani tek unë sepse jeni të lodhur, të mërzitur'. Këtë hir të Zotit e kërkoj me gjithë zemër për secilin prej jush, më shumë sesa rritja që do të kemi. Të jeni të sigurt se puna e Radio Marisë do të ketë gjithmonë sukses, por ky sukses pret pak më shumë për një frytshmëri më të madhe.

**... Vazhdon në numrin tjetër.**

**Bernhard Mitterutzner**  
**Përfaqësues i Radio Marisë Botërore**

### PRO CREDIT BANK

LLOGARIA NË **EURO 600388970102**

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 45209516090000600388970102

LLOGARIA NË **LEK 600388970001**

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 56209516090000600388970001

### INTESA SAN PAOLO BANK

LLOGARIA NË **EURO 1043631803**

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 25208110080000001043631803

LLOGARIA NË **LEK 1043631801**

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 79208110080000001043631801

### NË ZVICËR ME 5 FRANGA

Duke telefonuar në numrin:

**0900123411**

Në bankën **CREDIT SUISSE**

**RADIO MARIA**

LLOGARIA NË **CHF 361173-10-1**

IBAN: CH1804835036117310001